

Shoku qëlloi me pistoletë 25-vjeçarin, mister arsyet e plagosjes me armë në Lezhë. Dëshmia e shitëses në vendngjarje: Pashë një person që...

Sep 18, 2021 | 12:15

SHPËRNDAJE [f](#) [💬](#) [🐦](#) [📷](#) [🔗](#)

Një 25-vjeçar mbeti i plagosur me armë zjarri në Manati të Lezhës. Ngjarja ndodhi rreth orës 15:00 të së premtes në qendër të fshatit, ndërsa i plagosur mbeti shtetasi Paulo Bushi (Ndoj) banues në Manati.

Ai u qëllua dy herë me pistoletë në pjesën e këmbëve dhe u dërgua menjëherë për ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal të Lezhës, nga ku bëhet e ditur se ndodhet nën kujdesin mjekësor jashtë rrezikut për jetën.

NGJARJA

Policia e Lezhës, e cila mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes, identifikoi dhe shpalli në kërkim autorin e dyshuar të plagosjes.

Ai është shtetasi Xhulio Vokri, banues në Manati, ndërsa blutë janë vënë në ndjekje dhe po krehin të gjithë zonën me qëllim kapjen e tij. Nga tërësia e veprimeve hetimore rezulton se dy të rinjtë, banues në të njëjtin fshat dhe fqinj me njëri-tjetrin, janë konfliktuar për motive ende të paqarta.

Në debat e sipër, Xhulio Vokri ka nxjerrë armën, të cilën e mbante më vete, dhe ka qëlluar në drejtim të 25-vjeçarit e më pas ka arritur të largohet, duke i shpëtuar Policisë. Mësohet gjithashtu se autori i dyshuar dhe i plagosur ishin shokë të ngushtë midis tyre. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar dy gëzhoja pistolette “TT”. Gjithashtu, Policia lokale ka shoqëruar në Komisarariat disa persona për t’i marrë në pyetje.

Ata dyshohet se mund të kenë dijeni për ngjarjen. Nga të dhënat paraprake bëhet me dije se dy të rinjtë qëndronin shpesh me njëri-tjetrin dhe konflikti mes tyre ka qenë i çastit. Ka qenë babai i 25-vjeçarit ai që ka transportuar të birin për në Spitalin e Lezhës pasi e ka parë atë të gjakosur.

DËSHMIA

Zona ku ndodhi ngjarja është e populluar me banesa dhe biznese në të dyja anët. Shitësja e një dyqani thotë se ka dëgjuar krismat dhe kur ka dalë jashtë, e ka kuptuar se çfarë ka ndodhur. “Unë isha brenda në dyqan. Dëgjova krisma dhe dola menjëherë jashtë për të parë se çfarë ka ndodhur. Pashë një person që ishte i shtrirë në tokë dhe mbuluar me gjak. E morën dy veta dhe e futën në një makinë dhe e dërguan drejt spitalit. Atë që qëlloi nuk arrita ta shoh, se mund të jetë larguar shpejt”, thotë banorja. e. h.

© **Panorama.al**

Subscribe




Për t'u bërë pjesë e grupit të "**Panorama**" mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t'ju aprovohet.

KOMUNITETI PANORAMA ONLINE:

<https://facebook.com/groups/panoramaonline/>


Kliko këtu për të shkuar te Panorama Sport

JU REKOMANDOJMË




“Luli më tha që të lija mandatin sepse do dënohen fëmijët, i thashë...”/ Berisha: Basha është

panorama.com.al




Mbaj në kontroll diabetin!

Tea Bros




“Çfarë i kërkoni Kadri Hazbiu me Hekuran Isain, Xhevdet

panorama.com.al




Propolisi i bletës produkti që duhet të konsumoni përdit në

mjekesia.com




FOTO/ Auron Tare zbulon: Ivanka Trump ka vizituar Shqipërinë

panorama.com.al




Ju tregoj sekretin se si hoqa celularin në vetëm 10 ditë!!!

mjekesia.com




Nga punëtor në hekurudhë te vlerësimi i Enverit, rrëfimi special i Mirush Kabashit: Si u

panorama.com.al




Oferta mbi 40% ULJE. Na telefononi ose shkruani në WhatsApp

ENZO ATTINI




Lëkundje tërmeti në Shqipëri, ndihet edhe në Tiranë! Ja sa ishte

panorama.com.al




Dëshmia e bujshme: “Unë e qëllova Xhevdet Mustafën dhe e lashë të

panorama.com.al




Pse vdesin të vaksinuarit me dy doza? Profesor Dhimitër Kraja tregon tre faktorët që ndikojnë

panorama.com.al




Diacontrol, stabilizuesi natyral i nivelit të sheqerit në gjak!

Tea Bros




“E vranë pas shpine!”/ Historia e pritës në Sllatinë: Telegrami i

panorama.com.al




Propolis i bletës, antibiotik natyral. I duhuri për këtë

mjekesia.com




Rakacolli tregon masat ndaj pandemisë për dy javët e ardhshme/ Bino:

panorama.com.al




“E vranë pas shpine!”/ Historia e pritës në Sllatinë: Telegrami i

panorama.com.al




Propolis i bletës, antibiotik natyral. I duhuri për këtë

mjekesia.com




Rakacolli tregon masat ndaj pandemisë për dy javët e ardhshme/ Bino:

panorama.com.al




“E vranë pas shpine!”/ Historia e pritës në Sllatinë: Telegrami i

panorama.com.al



Propolis i bletës, antibiotik natyral. I duhuri për këtë

mjekesia.com



Rakacolli tregon masat ndaj pandemisë për dy javët e ardhshme/ Bino:

panorama.com.al

Na Kontaktoni

Adresa: Rr."Panorama" (prapa shkolles "Harry Kuiltz"). Nd.3, H.14, Ap.3, Njesia bashkiake nr.9, Kodi postar 1016, Tirane.

Website: www.panorama.com.al
NIPT: K22112005E

[Privacy Policy](#)

Partnerët tanë

Panorama Sport

Hysenbelliu Group

Revista Psikologji

Birra Korca

Universiteti Luarasi

Erjoni Ndertim

Hotel Prestige

Restaurant Prestige

Uji Fab

Omnifactor shpk

Na ndiqni

[f](#) **PËLQEJE**

[🐦](#) **NA NDJEK**

[▶](#) **ABONOHU**